

**RELACION**

**TEKNIK**

**Objekti: " Zbatim Rikonstruksion degezim rruge  
DRAÇIN"**



**INVESTITOR : BASHKIA SHKODER.**

**SIPERMARRES: TAULANT sh.p.k**

## RAPORT TEKNIK

**Objekti : “ Zbatim Rikonstruksion degezim rruge DRAÇIN”**

### Vendndodhja

Rruga (degezim) Dracin, ndodhet ne zonen lindore te qytetit, duke u kufizuar ne lindje me lagjen Vekshar, ne perendim me N/Stacionin "Shkodra 1", ne jug me lagjen kodrat e Tepes

Eshte ndertim relativisht i vjeter, qe i ka sherbyer banoreve per tu lidhur me pjeset e tjera te qytetit, por qe ne vitet '80 te shekullit te kaluar eshte perdorur dhe per ndertime te fortifikimeve ushtarake, ne kete zone

### Funksioni

Kjo eshte nje rruge e karakterit fushor-kodrinor, dhe pjesa qe po studiojme ka nje gjatesi prej 281.5 ml, dhe nje gjeresi 3-6 ml

#### **GJENDJA AKTUALE.**

Gjurma e rruges ekziston, pa pasur asnje cilesi tjeter per nje rruge, nga banoret e zones eshte ndertuar nje trotuar me gjeresi 1-1,5 m, i larte, per te krijuar mundesine e kalimit ne te ne kohet kur bien rreshje, meqenese kjo rruge eshte ndertuar ne vijen ujembledhese te faqes se ketyre kodrave

### Infrastruktura ekzistuese

Ky segment nuk ka te ndertuar rrjetin inxhinierik, KUZ, KUB.

Eshte rikonstruktuar vetem rrjeti i ujesjellesit, duke marre furnizimin nga rezervuaret e qytetit qe ndodhen mbi kodrat ku ndodhet rruga

Ne rruge jane te ndertuara linjat e tensionit 6kw dhe 20 kw

Nuk eshte ndertuar ndricim rrugor.

Nisur nga karakteristikat e objektit e te dhenat nga detyra e projektimit, si dhe nga gjendja faktike e objektit, **jane bere keto zgjidhje teknike:**

**RRUGA** – Kjo rruge do te trajtohet si rruge qarkulluese me te gjitha elementet ne vendet ku hapsirat gjeodezike e lejojne kete gje, duke krijuar mundesite edhe per te ndertuar trotuare nese ka mundesi

Rruga do te lidhet me unazen lindore te qytetit, nga dhe do te fillojne dhe referencat gjeodezike.

Eshte zgjedhur tipi rruges me gjeresi brr=4 m, me nje kunete betoni ne aksin e rruges me gjeresi, bk=0.5 m, dhe me dy trotuare, me gjeresi btr=1 m, ne nje segment te caktuar, ose me nje trotuar, ne nje segment tjeter, ose dhe pa trotuar.

Kjo rruge, me gjatesi Lrr=281.5 ml, me siperfaqe S=1140 m<sup>2</sup>, ka si nivelete te sajene te percaktuar ne profilin gjatesor, qe vjen duke u rritur si pjerresi .

Profili terthor i rruges do te jete me dy pjerresi 2% ne te dy krahet, per ne drejtim te aksit te rruges, ndersa ne gjatesi rruga do te kete pjerresi te ndryshme,ne segmente te ndryshme,qe kushtezohen nga terreni, dhe qe do te rakordojne me rrugicat qe dalin ne kete rruge,si dhe daljet-hyrjet,me rrugen e Unazes

Germimi I kasonetes do te behet me makineri, duke pase parasysh rrjetin inxhinierik ekzistues prane te cilit duhet te punohet me krah. Thellesia e germimit do te jete deri 30 cm duke pase parasysh qe kuotat e niveletes se rruges te jene pergjithesisht me te larta se kuotat ekzistuese per shkakun e mospermytjes se rruges.Ne cdo rast germimet do te kryhen me miratimin dhe prezencen e autoriteteve pergjegjes,qe administrojne rrjetet inxhinierike(KUZ,KUB,Ujesjelles,Elektrik,Telefoni).

Duke qene se materiali qe germohet,pritet te dale rreshpe te shtrsezuara duhet te kemi parasysh qe te perdoret per mbushje niveluese,te ngjeshura deri sa te arrijne fortesine e duhur

Shtresat rrugore duke qene se moduli i lengezimit i bazamentit eshte > 90N/mm<sup>2</sup>,dhe numri i kalimeve komerciale eshte i vogel ,do te jene nje shtrese cakell gurore tç=15 cm, nje shtrese zhavori ose çakell makinerie 20-40 mm,I ngjeshur, prej 10 cm ,shtrese cakell makinerie 5-20 mm, stabilizant prej 5 cm , shtrese binderi te gomuar 4 cm ,dhe shtrese asfaltobeton te gomuar 3 cm.Shtresat asfaltike do te jene prodhim dhe shtrim sipas teknologjise per asfaltet e gomuar( Asphalt Rubber)

Shtresa zavorit do te ndertohtet me zhavor lumi me homogjenitet granular, pa perberje argjile, lymi apo komponent te tjere vegetativ, e tille qe te siguroje modul deformacioni 800 kg/cm<sup>2</sup>, dhe per arritjen e kesaj hedhja e zhavorit te behet me shtresa 2x 15 cm, e ngjeshur me rul deri sa te arrije  $Y_{th}=1.95 T/m^3$  ose  $E=800 kg/cm^2$ , duke qene i shoqeruar si proces me lagje te vazhdueshme.

Materiali i zgjedhur per te realizuar shtresen e stabilizantit duhet te kete granulometri korale me permbajtje te grimces 2.5-20 mm dhe te kete deri ne 10% permbajtje pluhuri. Kjo shtrese cakulli me lartesi te shtreses 5 cm hidhet mbi shtresen e zhavorit te ngjeshur mire dhe me pjerresine e dhene sipes projektit, pa perberje organike dhe argjilore, laget e ngjishet me rul me te madh se 10 ton dhe me jo me pak se 8 kalime.

Pas ngjeshjes se cakellit te makinerise(stabilizant) siperfaqja laget me bitum 1.8 l/m<sup>2</sup>, me pike zbutjeje 40-47Grade C dhe me penetrim 80-100 mm , mbi te cilen pastaj nuk lejohet te kalojne mjete ose duhet te mbrohet me mbulimin me nje shtrese me granil 1 cm qe duhet te rulohet me 4 kalime me rul 10-12 ton.

Per sa i perket shtresave asfaltike jane marre parasysh kushtet klimatike te zones sipas tabelës se meposhtme,qe perkojne me zonen e dyte klimatike te territorit te Shqiperise;

STINA	Temperatura mesatare e stines per ajrin (grade C)	Mesatarja e ndryshimit termik ditor (grade C)	Rrezatimi diellor mesatar i stines (Kcal/m <sup>2</sup> ,d)	Shpejtesia mesatare vjetore e eres (km/ore)
DIMER	4.5	6	2718	13
PRANVERE	11.5	10.66	5785	
VERE	23.93	12.38	6337	
VJESHTE	15.03	8.3	3547	

Dhe eshte zgjedhur per tu perdorur binder dhe asfaltobeton i gomuar. Specifikimet e ketyre produkteve jane bashkelidhur

Cilesite fiziko-mekanike( te cilat do te provohen dhe pas shtrimit me ane te cekiceve dhe sondave,duke marre kampione ne tre vende , sipas STASH-561-80, "Metodat e provave te asfaltobetoni) qe duhet te plotesoje asfaltobetoni i ngjeshur ne te nxehte:

- Rezistenca ne shtypje ne temp.20grade C(R20) jo me pak se 25kg/cm<sup>2</sup>
- Rezistenca ne shtypje ne temp.50 grade C(R50) jo me pak se 10 kg/cm<sup>2</sup>(binderi 6kg/cm<sup>2</sup>)
- Koeficienti i qendreses kundrejt nxehtesise  $K_{nx}=R_{20}/R_{50}$  jo me shume se 2.5
- Koeficienti i qendreses ndaj ujit  $K_{uj}=R_{uj}/R_{20}$  jo me pak se 0.9
- Porozitetiti perfundimtar % ne vellim 3-5(binderi 7-10)
- Thithja e ujit ne % ne vellim jo me shume se 1-3(binderi 7-10)
- Mufatja ne % ne vellim jo me shume se 0.5( binderi 2)

**K.U.B** – Prezenca e rreshjeve te shumta ne qytet eshte nje nder problemet me shqetesues,por sidomos te kesaj rruge ,qe eshte ndertuar ne luginen e faqeve te kodrave,duke bere qe gjithe ujrat qe grumbullohen prej faqeve te kodres,te vijne per nje kohe te shkurter ne kete rrugedhe te rrjedhin poshte,duke bere te pakalueshme rrugen,si dhe veshtiresuar kushtet e jeteses se banoreve.

Shkarkimi I ujrave te bardha do te behet ne drejtim te rruges se unazes,me nje kolektor Ø1000 mm ,tuba betoni, qevendoset ne aksin e rruges qe po projektojme, deri ne pk. 11 ku dhe bashkohen dy rruget qe marrin ujrat e luginave siper.Ne hyrje te ketyre rrugeve,do te ndertohet kanali i mbuluar me zgare metalike,qe shkarkohet ne pusetat e kolektorit,te tlike kanal do te ndertohet dhe ne kryqezim te ketyre rrugeve(pk.11), pike ne te cilen do te ndertohen dy puseta,nga nje per secilin tubacion, dhe qe lidhen sebashku dhe shkarkohen ne kolektorin kryesor.

Sistemi i tubacioneve do te izolohehet ne maksimum ,per te minimizuar mundesine e funksionimit si sistem drenazhi,funksionim i cili do ta demtonte qendrueshmerine e rruges,dhe do te sillte demtimin e saj.

#### **KUZ** –

Shkarkimi i ujrave te zeza te rruges,do te behet ne nje linje ekzistuese qe ndodhet ne rrugen e Unazes ,Ø400mm,

Kanali i ujrave te zeza(KUZ) aksi do te ndertohet ne trupin e rruges,1.0 m nga faqja e bordures.Gjithe rrjeti do te jete Ø315 mm.

Para fillimit te punimeve duhet te kontrollohet pika e lidhjes ne kolektorin ekzistues

Para fillimit te punimeve ne linje , do te konsultohet dhe vendoset nga projektuesi dhe do te ndertohet ne prezencen e Ndermarrjes se ujesjelles-kanalizime Shkoder.

Tubacionet e brinjezuara , duhet te plotesojne kerkesat e standarteve STASH 518-87

**UJESJELLES** -Ujesjellesi eshte ndertuar vitet e fundit,duke marre furnizimin ne linje direkte me rezervuaret e ujit,te qytetit,qe ndodhen mbi koder

**NDRICIMI RRUGOR** – Ndricimi I rruges eshte i menduar te behet me shtylla metalike me lartesi 7m,qe ne zhvillimin linear do te vendosen ne distance 30 m,por dhe do vendosen ne pozicion te tille qe te kene akses ne cdo rruge e rrugice,qe ka dalje ne rrugen tone. . Kalimi I kabllit ne rastet e nderprerjes me keto rrugica do te behet me dy puseta kontrolli

elektrike qe vendosen ne cepat e dy trotuareve dhe lidhja e tyre me tub celiku 0 100x3 mm per perballuar ngarkesen nga automjetet ,ndersa ne trotuar do te jete me1 tub plastik 0 100x3 mm.Ndricuesit do te jene te tipit STAR VP Q(MBF)250W E40, me reflector prej alumini me lucidim te larte(98.8%),I paoksidueshem ,me rrezatim tip "cut-off",me portollampa porcelani me rregullator te dispozitivit,me xham te temperuar ,te shoqeruar me guarnicion gome me qendrushmeri te larte.Ndricuesi duhet te plotesoje normat EN 60598/1.

Pergjithesisht per cdo shtylle do te vendoset nje ndricues,me krah prej materiali njesoj si shtylla, me gjatesi ne plan se bashku me ndricuesin 1.5 m.

Lidhja e rrjetit te ndricimit me rrjetin elektrik te qytetit do te behet ne kabinen "Dracin 1" Shperndarja e energjise ne te gjithe gjatesine do te behet me kbell CU 4x10 mm<sup>2</sup>,qe pershkohet ne tub plastic Ø75mm, duke ndertuar mufta ne pusetat e furnizimit te cdo elementi

Shkoder, 2016

Per Shoqerine "Taulant"shpk



**Ing. Ditika QATIPI**